

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"WORTNOVA" SHPK**

Sot me daten 05/06/2024 (dymijë e njëzet e katër ), unë ortaku themelues :

- **I Znj. Mihaela Munteanu Manole, shtetas spanjoll, i datëlindjes 25 Dhjetor 1975, lindur në Rumani dhe banues në Spanjë, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. PAF517070.**

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj Shoqerinë me Pergjegjësi të Kufizuar " WORTNOVA" SHPK.

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të quhet " WORTNOVA" SHPK.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, Tiranë, Rruga Dëshmorët e 4 Shkurtit, shk. 1, kati 4, ap. 11 me numër pasurie 5/28071-11 ,zona kadastrale 8270.

**NENI 3**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Aktivitet në fushën e turizmit, hapja dhe manaxhimi i hoteleve, e godinave dhe ambjenteve në të cilat ushtrohet aktivitet hotelier. Menaxhim dhe administrim i pasurive të paluajtshme, kryesisht me veprimtari në Hoteleri – Turizëm. Investime në fushën e hotelerisë dhe turizmit, hapjen e bareve dhe restoranteve brenda këtyre strukturave, hapjen, administrimin dhe/ose menaxhimin e lojrave të fatit dhe kazinove brenda hoteleve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kryerje e shërbimeve të agjensive për veprimtari turistike brenda dhe jashtë vendit. Organizimin e aktiviteteve me natyrë sportive e argëtuese. Import – Eksport të mallrave e artikujve të ndryshëm industrialë dhe ushqimore, produkteve të estetikës dhe dermoestetikës, të pajisjeve dhe mjeteve të kazinove, aksesore hotelerie etj. Shërbim shpërndarje (Delivery) për bar dhe restoran. Hapja dhe manaxhimi i sallave të konferencave në kuadër të aktivitetit hotelier. Hapja, administrimi dhe / ose menaxhimi i funksionimit të qendrave të rekreacionit, me ose pa profil të dermo-estetikës, trajtimit të lëkurës dhe trupit , për masazhe, spa, mirëmbajtje trupore, fitness, dhe pishina. Aktivitet në fushën e qiradhëniec së zyrave, ambjenteve tregtare dhe/ose pasurive të tjera të paluajtshme që i përkasin hotelit. Konsulence

financiare. Projekte civile dhe industriale, punime të ndryshme ndërtimi si armim dhe disarmim armature, dërrasë dhe metalike, përpunime hekur ndërtimi, mirëmbajtje godinash dhe montim të kapanoneve industriale. Kryerja e aktiviteteve tregtare në fushën e projektimit dhe ndërtimit të veprave të ndryshme civile, private dhe publike dhe rikonstruksioni i tyre. Projektim dhe ndërtim i rrjeteve hidraulike, elektrike, të ajrimit dhe kondicionimit, restaurim dhe mirëmbajtje vepra arti dhe monumente kulture. Ndërtim ujësjellësash, kanale vaditës dhe kullues, impiante vaditëse dhe vepra të tjera mbrojtëse. Ndërtim rrugësh dhe urash të të gjitha kategorive, diga, tunele, galeri, si dhe mirëmbajtjen e tyre përfshirë dhe sinajlistikë rrugore. Prodhim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit. Import dhe eksport i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit, hidraulike, elektrike, etj. Vlerësimi i pasurive të paluajtshme. Eksport, import, tregti, dhënie me qera të automjeteve të tonazheve të ndryshme.

#### **NENI 4** **KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë "Wortnova" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 1 kuotë, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë).

Kontributi i ortakëve është i ndare si vijon:

**1. Mihaela Munteanu Manole zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.**

#### **NENI 5** **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhe kohe të pacaktuar.

#### **NENI 6** **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administrator i shoqërisë do të jetë

1- **Z. DOMINGO ROMILLO IRIARTE**, i cill emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marredhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

#### **NENI 7** **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me

të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendorur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**NENI 8**  
**NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpérndahet përbëhet nga fitimi i vitit finansiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.


**Neni 9**  
**LIKUJDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

**NENI 10**  
**MOSMARRËVESHJET**

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Tiranës për zgjidhje.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË  
"WORTNOVA" SH.P.K  
Mihaela Munteanu Manole**



*mihaela munteanu manole*